

KOMISIONI RREGULATIV I PROKURIMIT PUBLIK
REGULATIVNA KOMISIJA ZA JAVNE NABAVKE
PUBLIC PROCUREMENT REGULATORY COMMISSION

2024

RAPORT

**I statistikave të Prokurimit
Publik në Kosovë!**

JANAR – SHTATOR 2024

RAPORTI I STATISTIKAVE TË PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË

KOMISIONIT RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK (KRPP)

Periudha raportuese

Janar – Shtator 2024

Tabela e përmbajtjes

Lista e Tabelave	3
Lista e Figurave	3
Lisa e shkurtesave	4
HYRJE	5
Të dhëna kyçe	6
TË DHËNA TË DETAJUARA PËR PERIUDHËN RAPORTUESE	7
Përfundim.....	38

Lista e Tabelave

Table 1 Aktivitetet e inicuar të prokurimit dhe statusi aktual	7
Table 2 Statistika përmbledhëse të prokurimit për periudhën janar –shtator 2024 sipas segmenteve kryesore sipas numrit të aktiviteteve të inicuar	8
Table 3 Statistika përmbledhëse të prokurimit për vitin 2024 sipas segmenteve kryesore sipas numrit të kontratave të nënshkruara	10
Table 4 Procedurat e negociuara dhe annex kontratat	15
Table 5 Statistika të përgjithshme lidhur me aktivitetet e anuluar dhe të korrigjuara	35

Lista e Figurave

Figure 1 Vlera totale e aktiviteteve të inicuar sipas vlerës së parashikuar	9
Figure 2 Vlera dhe numri i kontratave të nënshkruara për periudhën Janar-Shtator 2024	11
Figure 3 Shuma dhe vlera sipas llojit të kontratës, dhe llojit të procedurës	12
Figure 4 Përqindja e aktiviteteve të inicuar dhe kontratave të nënshkruara sipas numrit të procedurës dhe vlerës së parashikuar.....	14
Figure 5 Aktivitetet e inicuar dhe kontratat e nënshkruara sipas vlerës dhe kriterit të dhënies	16
Figure 6 Dallimet në përqindje sipas vlerës dhe numrit të aktiviteteve tek aktivitetet e inicuar dhe kontratat e dhëna.....	18

Figure 7 Numri dhe vlera e aktiviteteve të iniciuara dhe kontratave të nënshkruara e shpërndarë në baza mujore në total dhe sipas llojit të kontratës.....	20
Figure 8 Aktivitetet e iniciuara dhe kontratat e nënshkruara sipas llojit të AK ndër muaj.....	22
Figure 9 Përdorimi në përqindje i kriterit të dhënies TEMF i shpërndarë në baza mujore, për aktivitetet e iniciuara dhe kontratat e nënshkruara	24
Figure 10 Numri dhe shuma e aktiviteteve të iniciuara dhe kontratave të nënshkruara e shpërndarë sipas autoriteteve kontraktuese	26
Figure 11 Autoritetet kontraktuese me numrin/vlerën më të madhe të kontratave të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë	27
Figure 12 Përqindja e aktiviteteve të hapura dhe negociuara sipas llojit të kontratës	29
Figure 13 Autoritetet kontraktuese me numrin/vlerën më të madhe të kontratave me vlerë të madhe	30
Figure 14 Diagram për distribucionin e autoriteteve kontraktuese sipas numrit dhe vlerës	32
Figure 15 Operatorët ekonomikë sipas numrit dhe vlerës së kontratave të nënshkruara.....	33
Figure 16 Operatorët ekonomik që kanë nënshkruar kontrata sipas procedurës së negociuar	34
Figure 17 Përqindja e aktiviteteve të anuluar dhe korrigjuara sipas muajve	36
Figure 18 Numri i anulimeve/korrigjimeve sipas Autoriteteve Kontraktuese	37

Lisa e shkurtesave

KRPP - Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik;

TEMF – Tenderi Ekonomikisht më i favorshëm (MEAT);

AK – Autoritetet Kontraktuese;

OE – Operator Ekonomik;

HYRJE

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) ka përgatitur këtë raport me qëllim të ofrimit të të dhënave statistikore mbi aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara nga të gjitha Autoritetet Kontraktuese në Kosovë për periudhën Janar – Shtator 2024. Ky raport paraqet një pasqyrë gjithëpërfshirëse të aktiviteteve të realizuara gjatë këtyre nëntë muajve dhe ndihmon në identifikimin e indikatorëve kyç që mund të kontribuojnë në përmirësimin e proceseve të prokurimit.

Gjatë periudhës raportuese, evidentohet se janë inicuar gjithsej 8,038 aktivitete prokurimi, janë nënshkruar gjithsej 6,981 kontrata, janë anuluar rreth 1,244 aktivitete të prokurimit dhe 205 aktivitete janë në proces nënshkrimi të kontratave.

Të dhënat statistikore për kontratat e nënshkruara gjatë kësaj periudhe janë mbledhur nga sistemi i prokurimit elektronik në përfundim të periudhës raportuese¹ ku tregohet se numri total i kontratave të nënshkruara është 6,981 me një vlerë totale prej 600.1 milion euro. Raporti ofron një përmbajtje të detajuar të kontratave në përputhje me vlerën e parashikuar, llojet e autoriteteve kontraktuese, llojet e kontratave, vlerat e kontratave, procedurat e përdorura, aneks-kontratat, operatorët ekonomik të shpërblyer, afatet e publikimit dhe kriteret e shpërblimit.

Përmes këtij raporti, KRPP synon të ofrojë mbështetje dhe të përmirësojë praktikën e prokurimit publik në Kosovë, duke kontribuar në një sistem më të efektshëm dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të fondeve publike.

¹ Të dhënat statistikore për kontratat e nënshkruara në numër dhe në vlerë dhe të paraqitura në këtë raport, mund të ndryshojnë në varësi të kohës së nxjerrjes së të dhënave nga sistemi. Kjo për arsye të procesit dinamik të prokurimeve dhe periudhës së publikimit të të dhënave (Njoftimeve për nënshkrim të kontratës, njoftimeve për anulim, etj) nga autoritetet kontraktuese.

Të dhëna kyçe

Disa nga të dhënat kyçe të këtij raporti për periudhën Janar-Shtator 2024 rezultojnë si më poshtë:

- Gjatë periudhës referuese Janar-Shtator 2024 janë inicuar 8,038 aktivitete të prokurimit publik, janë nënshkruar 6,981 kontrata dhe 205 janë në proces nënshkrimi;
- Vlera e parashikuar e kontratatve të nënshkruara arrinë shumën 866.2 milion euro, aktivitete të anuluar janë 154.8 milion euro dhe 62.4 milion euro janë në proces nënshkrimi;
- Vlera e kontratatve të nënshkruara për periudhën raportuese është 600.1 milion euro, nga të cilat 402.4 milion euro janë kontrata të nënshkruara nga niveli qendror dhe ndërmarrjet publike dhe 197.7 milion euro janë nënshkruar kontrata nga niveli lokal;
- Për periudhën raportuese sipas llojit të kontratës, janë nënshkruar 49.56% për punë (297.4 milion euro), 35.79% për furnizim (214.8 milion euro) dhe 14.65% për shërbime (87.9 milion euro);
- Sa i përket llojit të procedurës, 90.6% e kontratatve të nënshkruara janë zhvilluar me procedurë të hapur (544 milion euro), 7.4% me procedurë të negociuar (44.4 milion euro) dhe 1.94% janë punë shtesë apo annex kontrata (11.7 milion euro);
- Sipas vlerës në euro, rreth 76% e kontratatve të nënshkruara janë me vlerë të madhe, 21% me vlerë të mesme dhe rreth 3% me vlerë të vogël, minimale dhe mini-tenderë.
- Në raport me kriterin e dhënies 88.77% e kontratatve të nënshkruara janë shpërblyer sipas kriterit tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë dhe 11.23% sipas kriterit Tenderi ekonomikisht më i favorshëm (TEMF);
- Niveli qendror dhe ndërmarrjet publike janë Autoritetet Kontraktuese që kanë nënshkruar më së shumti kontrata me 67%, pasuar nga niveli lokal me rreth 33%.
- Sa i përket Autoriteteve Kontraktuese, numri më i madh i aktiviteteve të iniciuara, sipas vlerës në euro janë nga: Komuna e Prishtinës (104.5 milion euro), KEK (98.2 milion euro), Ministria e Infrastrukturës (75.8 milion euro) dhe AQP (62.1 milion euro);
- Për nga kontratat e nënshkruara autoritetet që kanë nënshkruar më së shumti kontrata gjatë kësaj periudhe janë: KEK (51.1 milion euro), Ministria e Infrastrukturës (50.1 milion euro), SHSKUK (46.1 milion euro) dhe Komuna e Prishtinës (33.6 milion euro).

TË DHËNA TË DETAJUARA PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

Në vijim ofrohen të dhëna statistikore përmbledhëse për disa nga indikatorët kyç të prokurimit publik në Kosovë për periudhën Janar-Shtator 2024, sa i përket aktiviteteve të inicuar dhe kontratave të dhëna.

Në përmbledhje, rezulton që për periudhën raportuese Janar-Shtator 2024, janë inicuar 8,038 aktivitete të prokurimit, nga të cilat 5,867 procedura kanë përfunduar me nënshkrim të 6,981 kontratave, 205 aktivitete janë në proces nënshkrimi. Aktivitete të anuluar rezultojnë të jenë rreth 1,244 ndërsa 814 aktivitete janë pa status final (që janë në fazën e dorëzimit të tenderëve, në vlerësim dhe aktivitete që kanë përfunduar me ankesë).

Table 1 Aktivitetet e inicuar të prokurimit dhe statusi aktual

	Numri	Proporcioni
Aktivitetet e inicuar	8038	1.000
Aktivitetet me kontrata të nënshkruara	5867	0.729
Aktivitete në proces nënshkrimi	205	0.025
Aktivitetet e anuluar	1244	0.154
Aktivitete pa status final	814	0.101

Tabela 2 ofron statistika përmbledhëse të aktiviteteve të prokurimit të inicuar të ndara sipas llojit të kontratës, llojit të procedurës, vlerës, kritereve të shpërblimit dhe llojit të Autoriteteve Kontraktuese. Sipas llojit të kontratës, për nga numri i aktiviteteve rreth 49% e aktiviteteve të inicuar janë për furnizim, 31% për shërbime dhe 20% për punë.

Për periudhën raportuese Janar-Shtator të vitit 2024, tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët është kriteri i dhënies së kontratës me numrin më të madh të aktiviteteve të inicuar. Ndërsa, sa i përket Autoriteteve Kontraktuese, institucionet qendrore dhe ndërmarrjet publike janë ato që kanë zhvilluar më shumë aktivitete të prokurimit me rreth 67%, kurse 33% janë zhvilluar nga institucionet lokale.

Table 2 Statistika përmbledhëse të prokurimit për periudhën janar –shtator 2024 sipas segmenteve kryesore sipas numrit të **aktiviteteve të inicuar**

	Numri	Proporcioni
Lloji i Kontratës		
Furnizim	3944	0.491
Punë	1605	0.200
Shërbime	2489	0.310
Lloji i procedurës		
Procedurë e hapur (përfshirë kuotimet e çmimeve, vlerë min, minitender)	7654	0.952
E Negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë	184	0.023
E Negociuar pa publikim të njoftimit (annex kontratat)	200	0.025
Sipas vlerës		
Mini tender	113	0.014
Vlerë e madhe	880	0.109
Vlerë e mesme	3340	0.416
Vlerë e vogël	1705	0.212
Vlerë minimale	2000	0.249
Kriteret e shpërblimit		
Procedura të prokurimit me kriterin TEMF	278	0.035
Procedura me kriterin Çmimi më i lirë	7760	0.965
Autoritetet		
Niveli lokal	2627	0.327
Niveli qendror/ Ndërmarrjet Publike	5411	0.673
Gjithsej	8038	




Figure 1 Vlera totale e aktiviteve të inicuar sipas vlerës së parashikuar²

Grafi më lartë në anën e majtë paraqet vlerën totale të aktiviteve të inicuar sipas vlerës së parashikuar. Nga këto mund të shohim që vlera e parashikuar e kontratave të nënshkruara arrinë shumë 866.2 milion euro, kurse 600.1 milion euro sipas vlerës së parashikuar janë shpërblyer dhe nënshkruar, ndërsa vlera e parashikuar e aktiviteve të anuluar rezultojnë të jetë 154.8 milion euro. Pa status final (që janë në fazën e dorëzimit të tenderëve, në vlerësim dhe aktivitete që kanë përfunduar me ankesë) janë 478 milion euro dhe 62.4 milion janë në proces nënshkrimi.

² Në grafin më lartë janë ta paraqitura vlera totale dhe numri i aktiviteve të inicuar sipas vlerës së parashikuar.

Table 3 Statistika përmbledhëse të prokurimit për vitin 2024 sipas segmenteve kryesore sipas numrit të **kontratave të nënshkruara**

	Numri	Proporcioni
Të gjitha kontratat e nënshkruara	6981	1.000
Lloji i Kontratës		
Furnizim	3512	0.503
Punë	1266	0.181
Shërbime	2203	0.316
Lloji i Procedurës		
Procedurë e hapur (përfshirë kuotimet e çmimeve, vlerë min, minitender)	6581	0.942
E Negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë	197	0.028
E Negociuar pa publikim të njoftimit (annex kontratat)	203	0.029
Sipas vlerës		
Mini tender	117	0.017
Vlerë e madhe	1236	0.177
Vlerë e mesme	2484	0.356
Vlerë e vogël	1218	0.174
Vlerë minimale	1926	0.276
Kriteret e shpërblimit		
Kontrata të nënshkruar me kriterin TEMF	280	0.040
Kontrata të nënshkruar ma kriterin Çmimi më i lirë	6701	0.960
Autoritetet		
Niveli lokal	2211	0.317
Niveli qendror/ Ndërmarrjet Publike	4770	0.683
Gjithsej	6981	

Tabela 3 ofron statistika përmbledhëse të kontratave të nënshkruara duke përfshirë llojin e kontratës, llojin e procedurës, vlerën, kriteret e shpërblimit dhe Autoritetet Kontraktuese. Nga kjo tabelë mund të shohim që për periudhën raportuese, sipas kategorisë së prokurimeve 50% e kontratave janë nënshkruar për furnizim, 32% për shërbime dhe 18% për punë. Sipas vlerës, dominon numri i kontratave me vlerë të mesme me rreth 35% e kontratave të nënshkruara janë me vlerë të mesme, 27% me vlerë minimale, kurse bazuar në kriteret e shpërblimit, sipas numrit më shumë kontrata të nënshkruara janë shpërblyer sipas kriterit të çmimit më të lirë. Niveli qendror dhe ndërmarrjet publike janë Autoritetet Kontraktuese që kanë nënshkruar më së shumti kontrata me rreth 68%, pasuar nga niveli lokal me 32%.








Figure 2 Vlera dhe numri i kontratave të nënshkuara për periudhën Janar-Shtator 2024

Grafi më lartë, paraqet vlerën dhe numrin totale të kontratave të nënshkuara Janar-Shtator 2024. Gjatë kësaj periudhe janë nënshkruar 6,981 kontrata në vlerë totale prej 600.1 milion euro, nga të cilat 402.4 milion euro janë për 4,770 kontrata të nënshkuara nga niveli qendror dhe ndërmarrjet publike dhe 197.7 milion euro janë për 2,211 kontrata të nënshkuar nga niveli lokal.



Numri i Procedurave

—◆— Vlera ne mil

Figure 3 Shuma dhe vlera sipas llojit të kontratës dhe llojit të procedurës

Grafi më lartë, tregon shumën/vlerën sipas llojit të kontratës dhe llojit të procedurës për aktivitetet e iniciuara (dy panelet lartë) dhe kontratat e nënshkruara (dy panelet poshtë).

Në panelin lartë në të majtë numri më i madh i aktiviteteve të inicuar është për furnizime 3,944 aktivitete, duke u pasuar nga shërbimet me 2,489 aktivitete dhe punët me 1,605 aktivitete. Në anën tjetër, vlera tregon një storie të ndryshme, edhe pse në numrin më të vogël vlera më e madhe (rreth 628.6 milion euro) i takon punëve, e ndjekur nga furnizimi (rreth 389 milion euro) dhe në fund shërbimet (rreth 207.6 milion euro). Sa i përket llojit të procedurës, me procedurë të hapur janë zhvilluar pjesa dërmuese në numër prej 7,654 aktivitete, apo në vlerë rreth 1,166.9 milion euro. Për t'u pasuar nga 184 aktivitete me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë apo në shumë prej 45.4 milion euro dhe 200 aktivitete punë shtesë apo 12.9 milion euro.

Ndërsa, në panelin poshtë, janë të paraqitura kontratat e dhëna, ku pjesa më e madhe e kontratave të nënshkruara, janë për furnizim apo sipas numrit 3,512 kontrata, 2,203 kontrata janë nënshkruar për shërbime dhe 1,266 për punë. Kurse sa i përket shumës prijnë kontratat për punë në vlerë prej 297.4 milion euro, për furnizim 214.8 milion euro dhe për shërbime 87.9 milion euro. Në grafën djathtas, nga kontratat e dhëna, rezulton që pjesa më e madhe e kontratave të nënshkruara apo 6,581 prej tyre në shumë prej 544 milion euro janë zhvilluar me procedurë të hapur, 44.4 milion euro sipas procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, dhe 11.7 milion euro punë shtesë apo annex kontrata.




Figure 4 Përqindja e aktiviteteve të inicuar dhe kontratave të nënshkruara sipas numrit të procedurës dhe vlerës së parashikuar





Në figurën 4, janë të paraqitura dallimet në përqindje sa i përket aktiviteteve të inicuar dhe kontratave të nënshkruara sipas numrit dhe vlerës së parashikuar. Nga të cilat, sa i përket aktiviteteve të inicuar, sipas numrit 50% janë për furnizim, 31% për shërbime dhe 20% për punë. Kurse referuar vlerës së parashikuar, kjo renditje ndryshon, ku 51.3% janë aktivitete të inicuar për punë, 31.7% për furnizime dhe 17% për shërbime. Në grafën djathtas, referuar vlerës së parashikuar, pjesa dërmuese apo mbi 95% janë parashikuar sipas procedurës së hapur.

Në dy grafet poshtë, janë paraqitur dallimet në përqindje për kontratat e nënshkruara sipas periudhës referuese. Bazuar në numrin e aktiviteteve, 50.3% e kontratave të nënshkruara janë zhvilluar për furnizim, 18.1% për punë dhe 31.5% për shërbime. Kurse, sipas vlerës në euro, 49.6% e kontratave të nënshkruara janë për punë, 35.8% për furnizim dhe 14.6% për shërbime. Nga ana tjetër, sipas llojit të procedurës, numri më i madh i kontratave të dhëna janë zhvilluar me procedurë të hapur apo rreth 94% e tyre. Po ashtu, bazuar në vlerë, pjesa dërmuese e kontratave të nënshkruara apo mbi 90% e tyre janë zhvilluar me procedurë të hapur.

*Procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë janë në total **56.1** milion euro, nga të cilat janë **11.7** milion euro janë punë shtesë (annex kontrata) apo në përqindje me totalin **1.94%**, dhe pjesa tjetër prej **44.4** milion euro janë procedura të negociuara apo **7.4%** të vlerës totale, të kontratave të nënshkruara.

Table 4 Procedurat e negociuara dhe annex kontratat

	Numri	Vlera me TVSH	Përqindja me totalin
Numri total	400	56.1 milion €	9.34%
Procedura e negociuar	197	44.4 milion €	7.4 %
Punët shtesë (Annex Kontrata)	203	11.7 milion €	1.94 %



Numri i Procedurave
 Vlera ne mil

Figure 5 Aktivitetet e inicuar dhe kontratat e nënshkruara sipas vlerës dhe kriterit të dhënies

Në grafet më lartë janë paraqitur aktivitetet e inicuar dhe kontratat e dhëna sipas vlerës dhe sipas kriterit të dhënies. Në pjesën e parë lartë, figuron që bazuar në numrin e aktiviteteve pjesa më e madhe e tyre janë inicuar me vlerë të mesme 3,340 aktivitete, për t'u pasuar nga ato me vlerë minimale 2,000 aktivitete, vlerë e vogël 1,705 aktivitete, vlerë të madhe 880 aktivitete dhe 113 janë mini-tender. Në të kundërt, sipas vlerës së parashikuar, 966.1 milion euro janë aktivitete të inicuar me vlerë të madhe, 242.7 milion euro me vlerë të mesme dhe të tjerat sipas radhës. Referuar kriterit të dhënies, tek aktivitetet e inicuar sipas vlerës së parashikuar dominon kriteri sipas tenderit të përgjegjshëm me çmimin më të ultë.

Në grafet poshtë, janë paraqitur kontratat e dhëna, ku sipas numrit prijnë me vlerë të mesme janë dhënë 2,484 kontrata, me vlerë minimale janë dhënë 1,926 kontrata, me vlerë të madhe janë dhënë 1,236 kontrata, me vlerë të vogël 1,218 kontrata dhe 117 janë mini-tenderë.

Kurse sipas vlerës në euro, 458.4 milion euro janë nënshkruar kontrata me vlerë të madhe, 129.3 milion euro janë nënshkruar kontrata me vlerë të mesme, duke u pasuar nga të tjerat në shumë të përafërt.

Referuar kriterit të dhënies, në krahasim me totalin rezulton që 6,701 kontrata në vlerë prej 532.7 milion euro janë dhënë sipas kriterit të tenderit të përgjegjshëm me çmimin më të ultë, ndërsa 280 kontrata në vlerë prej 67.4 milion euro janë dhënë sipas kriterit tenderi ekonomikisht më i favorshëm. Në përqindje totale, **88.77%** janë nënshkruar kontrata sipas kriterit çmimi më i ultë dhe **11.23%** sipas kriterit TEMF.








Figure 6 Dallimet në përqindje sipas vlerës dhe numrit të aktiviteteve tek aktivitetet e inicuar dhe kontratat e dhëna

Grafi më lartë tregon dallimet në përqindje sipas numrit të aktiviteteve dhe sipas vlerës për aktivitetet e inicuar dhe kontratat e dhëna. Në grafin e parë majtas, për nga vlera e kontratës, sipas numrit në përqindje më të madhe janë inicuar aktivitete me vlerë të mesme rreth 41.6%, aktivitete me vlerë minimale 24.9%, e aktivitete me vlerë të vogël 21.2%. Në një tjetër proporcion qëndrojnë dallimet në përqindje sa i përket vlerës së parashikuar, sipas të cilës, 78.9% janë parashikuar të inicohen aktivitete me vlerë të madhe, 19.8% me vlerë të mesme dhe pjesa tjetër në një proporcion më të përafërt.

Në grafin në anën e djathtë lartë, referuar kriterit të dhënies, sa i përket numrit të aktiviteteve, 96.5% janë sipas kriterit tenderi me çmimin më të ultë dhe 3.5% sipas tenderit ekonomikisht më të favorshëm. Një dallim i madh në shpërndarjen e përqindjes ekziston edhe tek vlerat e parashikuara, ku rreth 88.1% janë parashikuar të inicohen aktivitete sipas kriterit tenderi me çmimin më të ultë dhe 11.9% sipas kriterit TEMF.

Grafet poshtë paraqesin proporcionet në përqindje për kontratat e dhëna, sa i përket vlerës dhe kriterit të dhënies. Në grafin majtas, është paraqitur dallimi në përqindje sa i përket numrit të aktiviteteve dhe vlerës të kontratave të dhëna. Referuar numrit të aktiviteteve, përqindja më e madhe është tek ato me vlerë të mesme me rreth 35.6%, për t'u pasuar nga ato me vlerë minimale 27.6%, me vlerë të madhe 17.7% dhe 17.4% me vlerë të vogël. Kurse sipas vlerës së kontratës pjesa më e madhe e tyre janë nënshkruar me vlerë të madhe rreth 76.4%, pasuar nga vlerat e mesme rreth 21.5%, dhe të tjerat një përqindje më të afërt. Kurse, sa i përket kriterit të dhënies tek kontratat e nënshkruara, sipas numrit 96% e kontratave janë nënshkruar sipas kriterit të çmimit me të ultë dhe 4% sipas TEMF.

Sipas vlerës në euro, **88.8%** janë nënshkruar sipas kriterit të çmimit më të ultë dhe **11.2%** sipas TEMF.







—●— Furnizim —◆— Pune —■— Sherbime —▲— Te Gjitha

Figure 7 Numri dhe vlera e aktiviteteve të iniciuara dhe kontratave të nënshkruara e shpërndarë në baza mujore në total dhe sipas llojit të kontratës

Grafi 7 tregon numrin dhe shumën e aktiviteteve të iniciuara dhe kontratave të nënshkruara të shpërndarë në baza mujore në total dhe sipas llojit të kontratës.

Paneli lartë tregon që më së shumti aktivitete janë iniciuar gjatë muajve Mars (1,109) dhe Korrik (1,081). Kurse sipas vlerës prijnë muaji Gusht (191.3 milion euro) dhe Korrik (176.2 milion euro).

Kurse në panelin poshtë, më së shumti kontrata janë nënshkruar gjatë muajit Maj (1,009) dhe Korrik (989), kurse sipas shumës gjatë muajit Gusht janë nënshkruar kontrata në vlerë prej (102.7 milion euro) dhe gjatë muajit Korrik (89.5 milion euro).



—●— Niveli Lokal - - -◆- - - Niveli Qendror/Ndermarrjet Publike

Figure 8 Aktivitetet e inicuar dhe kontratat e nënshkruara sipas llojit të Autoritetit Kontraktues ndër muaj

Në grafën më lartë janë paraqitur aktivitetet e inicuar dhe kontratat e dhëna, të shpërndarë ndër muaj sipas llojit të Autoritetit Kontraktues. Në panelet lartë, janë paraqitur numri dhe shuma në euro e aktiviteteve të inicuar ndër muaj, nga të cilat numri më i madh i aktiviteteve të inicuar nga niveli qendror dhe ndërmarrjet publike, është gjatë muajve Mars (757) dhe Korrik (681), gjithashtu edhe nga niveli lokal gjatë këtyre muajve janë inicuar më shumë aktivitete, Korrik (400) dhe Mars (352). Referuar vlerës së parashikuar, nga niveli qendror dhe ndërmarrjet publike gjatë muajit Korrik (121.6 milion euro) ishin aktivitetet e inicuar kurse nga niveli lokal gjatë muajit Gusht janë inicuar më së shumti aktivitete me rreth (80.2 milion euro).

Në panelet poshtë, anën e majtë janë të paraqitura numri i kontratave të dhëna gjatë muajve, ku nga niveli qendror dhe ndërmarrjet publike më së shumti kontrata kanë dhënë në muajin Maj (700) dhe Korrik (641), ngjashëm me këtë edhe niveli lokal numëron më shumë kontrata të dhëna gjatë muajit Korrik (346) dhe Gusht (337). Ndërsa, referuar shumës në euro, në muajin Gusht janë nënshkruar (71.2 milion euro) kontrata nga niveli qendror dhe ndërmarrjet publike, dhe nga niveli lokal muaji Korrik (35.8 milion euro).




Figure 9 Përdorimi në përqindje i kriterit të dhënies TEMF i shpërndarë në baza mujore, për aktivitetet e iniciuara dhe kontratat e nënshkruara

Figura 9, tregon shkallën e përdorimit të kriterit TEMF, e ndarë sipas numrit dhe vlerës së aktiviteteve të iniciuara dhe kontratave të dhëna. Tek aktivitetet e iniciuara sipas numrit përqindja është relativisht stabile, ku lëviz nga 5.5% në muajin Prill vlera maksimale deri në 2.2% në Korrik vlera minimale. Një trend i ngjashëm shihet edhe tek kontratat e dhëna, që përqindja sipas numrit të aktiviteteve lëvizë nga 6.4% në muajin Mars si vlera më e madhe dhe 2.8% vlera minimale gjatë muajit Janar.

Në anën tjetër, duke e parë sipas vlerës tek aktivitetet e iniciuara përqindja më e madhe e përdorimit të këtij kriteri është gjatë muajit Janar 26.2% dhe Gusht 20.7%. Kurse sa i përket kontratave të dhëna, përqindja më e madhe e përdorimit të kriterit MEAT është tek muaji Mars 29.4%.

Figura 10 paraqet numrin dhe shumën e aktiviteteve të iniciuara dhe kontratave të nënshkruara të shpërndarë sipas autoriteteve kontraktuese, nga të cilat numri më i madh i aktiviteteve të iniciuara janë nga Komuna e Prishtinës 104.5 milion euro, KEK me gjithsej 98.2 milion euro, Ministria e Infrastrukturës me 75.8 milion euro dhe AQP me 62.1 milion euro aktivitete të iniciuara.

Në panelet poshtë janë të paraqitura kontratat e nënshkruara nga të cilat autoritetet që kanë nënshkruar më së shumti kontrata gjatë këtij viti janë KEK 51.1 milion euro kontrata, Ministria e Infrastrukturës 50.1 milion euro, SHSKUK 46.1 milion euro dhe Komuna e Prishtinës 33.6 milion euro.







Figure 10 Numri dhe shuma e aktiviteteteve të iniciuara dhe kontratave të nënshkruara dhe shpërndarë sipas autoriteteve kontraktuese






Figure 11 Autoritetet kontraktuese me numrin/vlerën më të madhe të kontratave të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë

Figura 11 paraqet autoritetet kontraktuese me numrin dhe vlerën më të madhe të aktiviteteve të iniciuara me procedurë të negociuar, nga të cilat prijnë Telekom i Kosovës me 16.8 milio euro, KEK me 7.7 milion euro dhe QKUK me 2.5 milion euro.

Ngjashëm edhe në panelet poshtë, janë të paraqitura autoritetet që kanë nënshkruar më së shumti kontrata me procedurë të negociuar nga të cilat kryeson Telekom i Kosovës me 16.8 milion euro, KEK me 8.3 milion euro kontrata të nënshkruara dhe QKUK me 2.5 milion euro.

Figura 12 në dy panelet lartë tregon proporcionet në përqindje të aktiviteteve të iniciuara me procedurë të hapur dhe të negociuar, të paraqitur sipas llojit të kontratës, të ndara në dy grafe të veçanta sipas numrit dhe vlerës së parashikuar, kurse në dy panelet janë kontratat e nënshkruara.

Paneli lartë paraqet proporcionin mes procedurës së hapur dhe asaj të negociuar, ku shihet që në të gjitha rastet mbi 90% e aktiviteteve të iniciuara dominojnë të jenë zhvilluar me procedurë të hapur e në një përqindje shumë të vogël procedurë të negociuar. Gjithashtu në panelin poshtë, nga të gjitha kontratat e nënshkruara gjatë këtij viti, pjesa më e madhe e tyre janë zhvilluar me procedurë të hapur.




Figure 12 Përqindja e aktiviteteve te hapura dhe negociuara sipas llojit te kontratës







Figure 13 Autoritetet kontraktuese me numrin/vlerën më të madhe të kontratave me vlerë të madhe

Në grafën më lartë, janë të paraqitura autoritetet me aktivitetet e inicuar dhe kontratat e dhëna me vlerë të madhe në numër dhe në shumë. Në grafet lartë, sa i përket aktiviteteve të inicuar me vlerë të madhe, sipas numrit prijnë KEK me 87 aktivitete, Komuna e Prishtinës me 54 aktivitete dhe SHSKUK me 53 aktivitete. Ngjashëm edhe sipas vlerës, dominon Komuna e Prishtinës me 95.6 milion euro, KEK me 86.1 milion euro aktivitete të inicuar me vlerë të madhe, dhe Ministria e Infrastrukturës me 74.5 milion euro.

Ndërsa, në grafet poshtë janë të paraqitura kontratat e dhëna me vlerë të madhe sipas autoriteve kontraktuese, nga të cilat për nga numri SHSKUK listohet e para me 178 kontrata, QKUK me 145 kontrata dhe Ministria e Shëndetësisë me 43 kontrata. Kurse, referuar shumës në euro, Ministria e Infrastrukturës ka nënshkruar më së shumti kontrata me vlerë të madhe me gjithsej 49.2 milion euro, KEK 46.5 milion euro dhe SHSKUK 45.2 milion euro.

Figura 14 parqet një pareto diagram të thjeshtuar të numrit dhe vlerës së aktiviteteve të inicuar. Vija e zezë paraqet përqindjen kumulative, ndërsa vija horizontale tregon pragun prej 80 përqind, vija vertikale tregon numrin e autoriteteve kontraktuese përgjegjëse për 80 përqind të numrit të aktiviteteve të inicuar ose vlerës së tenderëve.




Figure 14 Diagram për distribucionin e autoriteteve kontraktuese sipas numrit dhe vlerës




Figure 15 Operatorët ekonomikë sipas numrit dhe vlerës së kontratave të nënshkruara

Në grafën 15 janë të paraqitur operatorët ekonomik që janë shpërblyer me më së shumti kontrata gjatë periudhës referuese, të ndara sipas numrit të kontratave dhe vlerës në euro.




Figure 16 Operatorët ekonomik që kanë nënshkruar kontrata sipas procedurës së negociuar

Në grafën 16 janë të paraqitur operatorët ekonomik që janë shpërblyer me kontratë gjatë periudhës referuese sipas procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, të ndara sipas numrit të kontratave dhe vlerës në euro.

Tabela 4 paraqet një përmbledhje të statistikave të përgjithshme lidhur me aktivitetet e anuluar³ dhe të korrigjuara të prokurimit publik. Sa i përket aktiviteteve të anuluar, sipas llojit të kontratës 15% e tyre janë për furnizime dhe shërbime dhe 13% për punë. Sipas vlerës së kontratës rreth 20% e tyre janë anuluar me vlerë të mesme dhe të vogël dhe 16% me vlerë të madhe. Ndërsa, niveli qendror dhe ndërmarrjet publike janë autoritetet ato që kanë më shumë aktivitete të anuluar në krahasim me nivelin lokal.

Lidhur me aktivitetet e korrigjuara pjesa më e madhe e tyre janë për punë me rreth 21%, sipas vlerës së kontratës më së shumti aktivitete të korrigjuara kanë ato me vlerë të madhe 38% si dhe për nga autoritetet niveli lokal janë ato që kanë më shumë aktivitete të korrigjuara me rreth 24%.

Table 5 Statistika të përgjithshme lidhur me aktivitetet e anuluar dhe të korrigjuara

	(1)			(3)				(4)		
	Lloji i kontratës			Vlera e kontratës				Autoriteti Kontraktues		
	Furnizim	Pune	Sherbime	Mini-Tender	Vlere e madhe	Vlere e mesme	Vlere e vogel	Vlere minimale	Niv. lokal	N. qendror/Nd. Publike
Aktivitete te anuluar	0.15	0.13	0.15	0.02	0.16	0.20	0.21	0.01	0.12	0.16
Aktivitete te korrigjuara	0.09	0.21	0.11	0.00	0.38	0.17	0.04	0.00	0.17	0.10
Numri i korrigjimeve	0.12	0.30	0.15	0.00	0.61	0.21	0.04	0.00	0.24	0.13
Gjithsej	8038			8038					8038	

³ Në numrin e aktiviteteve të anuluar, janë përfshirë anulimet që ju takojnë procedurave të inicuar gjatë vitit 2024 dhe nuk janë përfshirë anulimet që kanë të bëjnë me procedurat me vlerë minimale.




Figure 17 Përqindja e aktiviteteve të anuluar dhe korigjuara sipas muajve

Figura 17 paraqet përqindjen e aktiviteteve të anuluar dhe të korigjuara të ndara sipas muajve, nga të cilat përqindja më e madhe e aktiviteteve të anuluar ka qenë gjatë muajve Shkurt me 17.8%, Mars 17.5% dhe Prill e Maj 16.3%.

Kurse, sa i përket aktiviteteve të korigjuara, muaji Gusht rezulton të ketë përqindjen më të lartë me rreth 15.6%, për t'u pasuar nga muaji Prill 13%.





Figure 18 Numri i anulimeve/korigjimeve sipas Autoriteteve Kontraktuese

Grafi më lartë paraqet numrin e aktiviteteve të anuluar dhe të modifikuara sipas Autoriteteve Kontraktuese.

Përfundim

Në përfundim të raportit për periudhën Janar-Shtator 2024, mund të theksojmë se aktivitetet e prokurimit publik kanë demonstruar një dinamizëm dhe trend të përafërt me peridhën e njejtë të vitit 2023, në raport me vlerën e kontratave të nënshkruara dhe kriterit të dhënies së kontratës, derisa është evdientuar një rënie e dukshme e vlerës së kontratave me procedurë të negociuar në krahasim me periudhën e njejtë të vitit paraprak. Janë inicuar gjithsej 8,038 aktivitete dhe janë nënshkruar 6,981 kontrata, duke ofruar një trend të qartë mbi dinamikën e prokurimeve sipas vlerës së parashikuar dhe shpërndarjen e kontratave.

Vlera totale e kontratave të nënshkruara arrin në 600.1 milion euro, e cila është e ndarë mes niveleve qendrore dhe lokale, duke reflektuar përpjekjet e vazhdueshme për të përmbushur kërkesat dhe nevojat në sektorë të ndryshëm. Mbizotërimi i procedurës së hapur, si dhe shpërndarja e kontratave sipas llojit dhe vlerës, sigurisht që kontribuojnë në përmirësimin e transparencës dhe konkurrencës në proceset e prokurimit publik.

Në të njëjtën kohë, analiza e dhënies së kontratave sipas kriterit të çmimit më të lirë dhe ndarja e kontratave në nivele të ndryshme të qeverisjes sugjeron një përpjekje për të rritur efikasitetin dhe përfitimet ekonomike.

Një analizë më e detajuar për të gjitha të dhënat mbi aktivitetet e prokurimit, kontratat e nënshkruara dhe zhvillimet në sektorin e prokurimit publik gjatë vitit 2024, KRPP do t'i përfshijë në raportin vjetor për vitin 2024 i cili do të përgatitet dhe publikohet në pajtueshmëri me obligimet ligjore.

